



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:023905

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417185

2022:023906

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Armend Ahmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Idrizi, në çështjen kontestimore të paditëses A.S. me vendbanim në Ferizaj, me numër personal ..., të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Fitim Shabani nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E." me seli në Prishtinë me përfaqësues me autorizim E.A., me bazë juridike kompensim dëmi material dhe jo material, me vlerë të kontestit 4,780.⁰⁰€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datën 15.02.2024, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse mori ndërsa me datën 06.03.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.S. nga Ferizaj, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "E." me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 27.10.2021, rreth orës 08:20 min, lokacioni Veternik, t'ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 3,620.00 € (tre mijë e gjashtëqind e njëzetë euro) edhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1,600.⁰⁰ €,
- Në emër të frikës shumën prej 1.600.⁰⁰€,
- Në emër të ndihmës të personit të tretë shumën prej 210.⁰⁰€ dhe
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 210.⁰⁰€.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses A.S. dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 400.00€, në emër të frikës shumën prej 400.00 €, në emër të ndihmës të personit të tretë shumën prej 105.⁰⁰€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 105.⁰⁰€ dhe në emër të shërimit klimaterik shumën prej 150, ⁰⁰€.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë që t’ia paguaj paditëses A.S. shumën e gjykuar në pikën I. të këtij dispozitivi me kamatë vjetore prej 8% për dëmin material nga dita e paraqitjes së padisë (07.02.2022) ndërsa për dëmin jo material nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjer në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 714.⁰⁰ Euro (shtatëqind e katërmbëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja nëpërmjet të autorizuarit të saj me datë 07.02.2022 ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material. Paditësja nëpërmjet të autorizuarit të saj në padi dhe në seancat e mbajtura dhe në fjalë përfundimtare ndër të tjerash ka deklaruar se paditësja ka pësuar aksidentin e komunikacionit, që ka ndodhur me datën 27.10.2021 rreth orës 08:20 në Veternik në Prishtinë ku ishin të përfshira dy njësi vozitësi (Njësia A) me të arritur në Veternik nuk e kishte përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës dhe me pjesën e parë të veturës e godet prapa veturën e Njesisë B, e cila më pas e godet Njësia C prapa të cilat ishin duke lëvizur ngadalë në kolonë në shiritin e majtë ku si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime paditësja e cila ishte duke drejtuar Njësia C, e njëjta në atë kohë ishte shtatzënë në muajin e dytë, dhe nga aksidenti ka pësuar shqetësime emocionale, dridhje të duarve, dhe këmbëve, dhimbje koke, frikë dhe ankth të intensitetit të lartë dhe të mesëm, pasi që në këtë rast nuk ishte kontestuse baza e kërkesëpadisë por vetëm lartësia sepse e paditura i kishte ofruar paditëses ofertë për marrëveshje jashtëgjyqësore, por për shkak të lartësisë paditësja nuk kishte pranuar. Përmes parashtresës së precizimit të kërkesëpadisë paditësja përmes të autorizuarit të saj ka kërkuar që në emër të dëmit jo material t’i kompensohet për dhimbjet fizike shumën prej 2.000.00 euro, për frikën e pësuar shumën prej 2.000.00 euro, në emër të dëmit material për ndihmë nga personi i tretë shumën prej 315.00 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 315.00 euro, për shërim klimatik shumën prej 150.00 euro, në shumën e përgjithshme të kompensimit prej 4,780.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi si dhe gjatë seancave të mbajtura ndër të tjerash ka deklaruar se nuk e kundërshton bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit ndërsa e kundërshton lartësinë e

saj, pasi një kërkesë e tillë është tejet e lartë dhe jo në proporcion me shkallën e lëndimit dhe mendimin e ekspertëve mjekësor. Duke kërkuar që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses si dhe fakti se e njëjta ka qenë shtatzënë në kohën e aksidentit është irelevante për shkak se e njëjta nuk ka pasur asnjë pasojë ose dëmtim të fetusit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sërë provash. Gjykata pasi vlerësoj provat e administruara ka vërtetuar këtë gjendje faktike: me datën 27.10.2021 rreth orës 08:20h në Veternik në Prishtinë deri tek aksidenti ka ardhur kur shoferi i njësisë A me të arritur në Veternik drejtimi i Prishtinës, në rrugë nacionale duke mos e përshtatur shpejtësinë ndaj kushteve të rrugës dhe me pjesën e parë të veturës e godet prapa Njësinë B, dhe nga inercioni i goditjes Njësia B godet Njësinë C prapa të cilën veçanërisht duke lëvizur ngadalë në kolonë në shiritin e majtë rrugor, në atë intervalin kohor edhe shoferi i njësisë D me pjesën e parë e godet Njësinë A prapa ku si pasojë e aksidentit lëndime pësojnë shoferët e veturave B dhe C dhe dy pasagjerë të veturës B, si dhe shoferja e veturës A dhe pasagjerja e veturës A që ka kërkuar ndihmë mjeksore.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar. Gjykata nga analizimi i Raportit të Aksidentit të evidentuar si 2021-AR-... të datës 27.10.2021, ka vërtetuar faktin se aksidenti ka ndodhur me datën 27.10.2021 rreth orës 08:20h në Veternik Prishtinë, me ç'rast ka ardhur edhe pasoja e shkaktuar ana e të siguruarit të palës së paditur, respektivisht nga ky raport është vërtetuar se vozitësi i njësisë A një ka qenë shkaktar i aksidentit dhe se aksidenti ka ndodhur me fajin e tij. Gjykata nga analizimi i të gjitha raporteve mjekësore të paditëses veç e veç të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të cilat janë në emër të paditëses, ka vërtetuar faktin se paditësja si rezultat i aksidentit ishte dërguar për të marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor. Këto raporte mjekësore kanë pasqyruar gjendjen reale dhe faktike të shëndetit të paditëses pas ndodhjes së aksidentit dhe se nga këto raporte janë bazuar edhe ekspertët përkatës të cilët kanë bërë ekspertizën mjekësore, ku vërtetohet lidhja shkakore në mes të shkaktimit të dëmit dhe lëndimeve trupore të paditësit. Gjithashtu, sipas raporteve mjekësore vërtetohet fakti se paditësja në kohën e aksidentit ka qenë shtatzënë në muajin e dytë të shtatëzënisë dhe si pasojë e kësaj gjendje të paditëses gjykata pati parasysh si rrethanë kur vlerësoi dhimbjen e pësuar në aksident

si dhe frikën e cila është evidentuar edhe në raportet e ekspertëve. Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese baza e përgjegjësisë lidhur me detyrimin e palës së paditur për të kompensuar dëmin material dhe jo material paditëses, për më tepër detyrimin e saj pala e paditur nuk e ka kontestuar fare. Mirëpo, kontestuese ishte lartësia e kompensimit të dëmit material dhe jo material, e lidhur me këtë, janë nxjerrë provat nëpërmjet ekspertizave përkatëse përkatësisht ajo psikiatrike dhe e ortopedisë, në mënyrë që të bëhet kualifikimi i lëndimeve dhe intensiteti i tyre, e të cilat do të elaborohen më poshtë.

Ekspertizë e ekspertit B.I.-ortoped traumatolog, i cili ka konstatuar se paditësja A.S. ka pasur shtypje të kokës, shtypje dhe përdredhje e unazave të qafës, shtypje e belit, shtypje e regjionit të barkut, të cilat dëmtime kualifikohen si lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëdetit, ndërsa dhimbjet fizike të intenzitetit posaçërisht të rëndë ka përjetuar: - 30 min, dhimbje të intenzitetit të rëndë: - 14 –ditë, Dhimbje të intenzitetit të lehtë: - 8 –javë. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Ka theksuar se nuk ka shëmtim trupor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 21-ditë. Ndhima dhe kujdesi nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 21-ditë. Rehabilitim klimaterik në kohëzgjatje prej 10-ditë, rehabilitim në një nga banjat e vendit apo përmes fizioterapisë, qendra këto të cilat ndihmojnë në rivitalizimin e indeve të dëmtuara si dhe kthimin e lëvizjeve në normalitet.

Ekspertizë e ekspertit N.M.-psikiatre, e cila ka theksuar se në momentin e dëmtimit dhe gjatë trajtimit mjekësor, i dëmtuari ka pas këto frikë primare: Me intensitet posaçërisht disa sekonda manifestuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtëpërdrejtë për integritet të saj dhe të frytit pasi që ka qenë shtatëzënë. Me intensitet të lartë 2 ditë - kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet trupore. Me intensitet të lartë që ka zgjatur 3 ditë- manifestuar me reagim të stresit akut pas traumës, manifestuar me frymënxënie therrje gjoksi, ndjenjë të ngulfatjes gjatë kohës së egzaminimeve mjekësore. Me intensitet të mesëm 1 muaj- manifestuar me rikujtime të ngjarjes traumatike, çrregullim të gjumit, stres për gjendjen shëndetësore të frytit të saj, brengë për ecurinë e mjekimit, vështirësi për adoptim, reagime emocionale. Me intensitet të ulët- 6 muaj me ndjeshmëri emocionale, shqetësime para gjumit, frikë nga pasoja e aksidentit, brengë për gjendjen e frytit të saj.

Gjykata ia fali besimin e plotë ekspertizës së psikiatrisë të punuar nga ana e ekspertit Dr. N.M. dhe ekspertizës së ortopedisë të punuar nga eksperti B.I., kjo për faktin se të njëjtat janë arsyetuar mjaftueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat, Gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Poashtu palët në procedurë nuk kishin vërejtje në ekspertiza dhe as nuk kishin pyetje sqaruese për ekspertët. Gjykata vlerëson se nga këto

ekspertiza është vërtetuar lidhja kauzale–shkakore në mes veprimit të paligjshëm - aksidentit, dhe pasojës së shkaktuar - lëndimeve trupore të paditëses. Pra, ekspertizat e lartcekura kanë vërtetuar faktin se nga aksidenti i shkaktuar, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, rrjedhimisht ka pasur nevojë edhe për ushqim të përforcuar, ndihmë të personit të tretë dhe shpenzime mjekësore për të shëruar dhimbjet e saj, me ç‘rast kjo përkujdesje mjekësore ka pasur edhe një kosto financiare të financuar nga vetë paditësja. Ndërsa, sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit jo material, gjykata vendosi mbi bazën e bindjes së lirë që të aprovoj shumat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse shumat e aprovuar kanë për qëllim që të japin satisfaksionit moral dhe shpirtëror paditësen, e konform nenit 323 të LPK.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar

Gjykata vendosi ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, pasi që është vërtetuar baza e përgjegjësisë së dëmit, të cilën e ka shkaktuar i siguruari i palës së paditur, ky fakt nuk ishte kontestues nga ana e palës së paditur, për më tepër e njëjta e ka pranuar bazën juridike të kërkesëpadisë mirëpo e kundërshtuar vetëm lartësinë e kërkesës së palës paditëse. Është vërtetuar edhe baza juridike e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, pasi që në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 136, par. 1 përcaktohet se "Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij." Në nenin 169 të LMD-së, është përcaktuar se "Personi përgjegjës ka për detyrim ta rivendos gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Kur rivendosja nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do t'i caktojë që ai t'ia paguaj dëmtuesit shumën përkatëse në të holla në efekt të kompensimit të dëmit." Më tutje në nenin 137 i LMD-së përcaktohet se: "Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit." Ndërsa në nenin 140 i LMD-së, përcaktohet se: "Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia". Me paragrafin 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se: "Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror". Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara, frikës së të dëmtuarës ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin

satisfaksion të vërtetë për paditësen për aq sa është e mundur, duke ndikuar në zbutjen e pasojave negative që i janë shkaktuar paditësit me rastin e aksidentit, e marrë për bazë edhe faktin se e njëjta në kohën kur është shkaktuar aksidenti ka qenë shtatzënë andaj edhe një gjendje e tillë e paditëses e bën edhe më kompleks rastin për shkak të përjetimit të saj të dyfishtë të këtij aksidenti. E që lidhur me këtë, gjykata vlerëson se shumat e aprovuara janë në përputhje të plotë me dëmin material dhe jo material si pasojë e aksidentit në fjalë. Sipas praktikës gjyqësore në parim shumat për dhimbje fizike janë më të larta se për frikë, por duke pasur parasysh rrethanat e rastit se paditësja ishte shtatzënë gjykata ka vendosur ti lë shumat e njëjta/barabarta. Gjykata nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, ndërsa si bazë për aprovimin e kërkesëpadisë e mori, Raportin e policit hetues, dokumentet mjekësore të vërtetuara edhe nga ekspertizat e ekspertëve përkatës mjekësore ortoped dhe psikiatër të cilët kanë konstatuar se me rastin e shkaktimit të aksidentit ka ardhur edhe tek pasoja e pësuar respektivisht lëndimet e lehta trupore të paditëses, e mbi bazën e saj, e njëjta ka përjetuar edhe dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmë të personit të tretë dhe ushqim të përforcuar. Andaj, Gjykata ia fali besimin provave të administruara dhe vendosi që të paditurën ta detyroj që e njëjta të kompensoj dëmin e shkaktuar në lartësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ndihmës së personit të tretë, t'ia paguajë paditëses shumën prej 210,00 Euro, duke marrë për bazë se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën ditore prej 21 ditësh, konform nenit 323 të LPK. Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditëses shumën prej 210,00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësja si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditësh, konform nenit 323 të LPK. Sa i përket shërimit klimaterik, kjo pjesë e kërkesës refuzohet sepse paditësja nuk ka sjellur prova që e ka realizuar këtë shërim klimaterik në ndonjë banjë ose qendër të specializuar.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e miratuar në lartësi të pikës I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që shumat e kërkuara si në precizimin e kërkesëpadisë ishin shuma të larta e të cilat nuk përkojnë me praktikën gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë se shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material nr. ..., datë 27.02.2023. Gjykata e bazoi

duke marr parasysh llojin e lëndimit të paditëses, dhimbjet e përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, e duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, në vlerësimin e lirë ka ardhur në përfundim se shumatat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e pësuar të paditëses për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Gjykata sa i përket kamatës është bazuar në nenin 382 të LMD-së, përkatësisht kamata për dëmin material të rrjedh nga e paraqitjes së padisë, e cila llogaritet si kohë kur është ditur shuma e kompensimit si dhe arritja e përmbushjes së detyrimit. Ndërsa sa i përket dëmit jo material nga dita e nxjerrjes të këtij aktgjykimi. Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit paditëses, Gjykata në bazë të nenit 382 të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 265/2020, të datës 02.12.2020 bazuar në pjesën e dytë, pika VI, ka vendosur që lartësia e kamatës të jetë 8%, ndërsa referuar periudhës së pagesës së kamatës bazuar po në këtë Mendim Juridik në pjesën e tretë, pika XIV të tij.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditëses të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në kuptim të nenit 452.1 dhe 463.1 të LPK në shumën e përgjithshme prej 714.⁰⁰, prej të cilave shpenzime, për përpilimin e padisë në shumën prej 104 €, për 2 seanca të mbajtura në shumën prej 270€, për ekspertiza në shumën prej 300 €, konform TOAK si dhe për taksë për padi në shumën prej 40 € (të parapara sipas Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 të KGJK lidhur me unifikimin e taksave gjyqësore).

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 06.03.2024

Gjyqtari
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.